



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr.37, datë 25.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”
ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE QË
NXIRREN NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE, PËRRENJVE, LIQENEVE,
ME OSE PA UJË, ME VENDNDODHJE: SHTRATI I LUMIT TË HURDHËS,
DEGË E LUMIT MAT, TË SUBJEKTIT “BAMI HOLDING” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 8, pika 3, gërma (a) dhe nenit 141, pika 3 të ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore” i ndryshuar, Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar si dhe Vendimit Nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I.

1. Miratimin e lejes “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me

vendndodhje: Shtrati i Lumit të Hurdhës, degë e Lumit Mat, Bashkia Kurbin, subjektit “Bami Holding” sh.p.k, për zbatimin e projektit “Zgjerimi i superstradës Franë - Durrës (Faza I)” sipas kontratës me ARRSH, REF-99896-04-02-2024 me Nr. 2272/7, prot, datë 08.07.2024.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri burimit ujq: Lumi Hurdhës

Koordinatat e konturit të sheshit për shfrytëzim (KRGJSH):

Nr	X	Y	Z
1	482837.66	4617558.23	29.0
2	482983.35	4617456.59	28.6
3	482901.50	4617382.30	32.8
4	482831.90	4617299.00	33.9
5	482781.92	4617238.67	34.6
6	482725.85	4617258.47	36.1
7	482746.27	4617319.82	33.9
8	482801.84	4617456.65	31.6

Koordinatat e vendit të depozitimit (KRGJSH):

Nr	X	Y	Z
1	480986.8	4618694.3	30

3. Sipërfaqja e taracës lumore që do të shfrytëzohet : **34165.57 m²**;

4. Volumi i materialit të kërkuar : **60 000 m³**;

5. Subjekti të respektojë të gjitha sygjerimet e dhëna nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;
6. ~~Shitje~~ tëzimi i inerteve të bëhet mbi nivelin maksimal të pasqyrës së lumit;
7. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU Ishëm-Erzen-Mat për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
8. Të ndiqet nga ZABU Ishëm-Erzen-Mat zbatimi i projektit të rehabilitimit;
9. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
10. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi;

Ky vendim pas nënshkrimit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDIRAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BAELUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



DREJTOR I AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
ANILA SHERU



Nënshkruar më datë 17/07 2025